

**STATUT AKT-THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“RENTAL CAR NEAR ME” shpk**

**KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1:
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

1. Sot, më 08.08.2023 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “RENTAL CAR NEAR ME” shpk.
2. Themeluesit e shoqërisë janë:
ERSI DINAJ, shtetas Shqipetar, identifikuar, me numër personal identifikimi K01026088J i datëlindjes 26.10.2000, lindur në Tirane dhe banues në Tirane; madhor me zotësi të plotë per te vepruar.
DORJAN DINAJ, shtetas Shqipetar, identifikuar, me numër personal identifikimi J30510106Q, i datelindjes 10.05.1993, lindur në Tirane dhe banues në Tirane; madhor me zotësi të plotë per te vepruar.
ESMERALDA KAPLLANI, shtetase Shqipetare, identifikuar, me numër personal identifikimi I35705065L e datelindjes 05.07.1983, lindur ne Tirane dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesi te pote per te vepruar.

**Neni 2:
Objekti**

1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e meposhtem:
Aktivitet ne fushen e shit-blerjeve, dhenia me qera e makinave dhe mjetave te tjera te transportit.

**Neni 3:
Kohëzgjatja**

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:
Selia**

1. Shoqëria e ka selinë në: Rruga Petro Marko, Godina nr. 4, Yzberisht, Tirane.
2. Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**KREU II
KAPITALI**

**Neni 5
Kapitali themeltar**


1. Kapitali themeltar filletar i shoqërisë është 100000 (njeqindmije) Lekë dhe është i ndarë në 3 (tre) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a- Ortaku themelues **ERSI DINAJ**, zotërues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 34000 (tridhjete e kater mije) Lekë, që përbën 34 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - b- Ortaku themelues **DORJAN DINAJ**, zotërues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 33000 (tridhjete e tre mije) Lekë, që përbën 33 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - c- Ortaku themelues **ESMERALDA KAPLLANI**, zotërues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 33000 (tridhjete e tre mije) Lekë, që përbën 33 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Faqe 1 e 6

**Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
shpk**



1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
4. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a. kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b. shitblerjes;
 - c. trashëgimisë;
 - d. dhurimit;
 - e. çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organë Vendimmarrës

1. Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj
3. Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b. ndryshimet e statutit;
 - c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e. përcaktimin e shpërbilimeve për personat e përmendur në shkrnjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i. pjesëtimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
 - j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vlijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Faqë 2 e 6

*Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
shpk*

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10 Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zotëruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :
 - a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d. përcaktimin e shpërblimeve
 - e. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - f. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - g. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKR për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d. dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesë, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 Administrimi

1. Administratori i shoqërisë emërohet z. ERSI DINAJ me numer id. K01026088J i datëlindjes 26.10.2000, lindur në Tirane dhe banues në Tirane, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.



2. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
3. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
4. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Neni 14
Kompetencat e Administratorëve

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a. kryejnë të gjitha veprimet e administritimit të veprimitarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c. kujdesen përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarisë dhe, së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
 - e. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimitarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - g. raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmes tregtareve të shoqërisë tregtare;
 - h. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë te detyruar te thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

1. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston reziku që aktiviteti i shoqërisë nuk i mbulonjë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- a. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- b. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojet administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15
Përgjegjësítë e Administratorit

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo përfajë të kryera gjatë administritimit të shoqërisë.
2. Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
 - a. të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kuqshuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarisë së shoqërisë në mëdus;
 - b. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm përritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, përfshirë merret vendim;
 - d. të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - e. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
5. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, atë përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
6. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
 - a. u kthen ortakëve kontributet;
 - b. u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c. u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - e. jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkuesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR, EKSPERTET

Neni 16 Viti Financiar

1. Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 17 Ekspertet

1. Eksperti ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij përrastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
2. Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ju paraqesë e dorëzojë ne kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

KREU V PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18 Prishja dhe likuidimi

1. Shpërndarje ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe:
 - a. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b. me vendim të Asamblesë se Ortakeve;
 - c. me hapjen e procedurave të falimentimit;

Faqe 5 e 6
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
_____ shpk

d. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin.

e. me vendim të gjykatës;

Ne ketë rast Ortakët marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri ne likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërlimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidim.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja

- Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

- Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me ketë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.
- Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

- Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njoitura nga ligji.

ORTAKËT
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"RENTAL CAR NEAR ME" shpk

(ERSI DINAJ)
(DORJAN DINAJ)
(ESMERALDA KAPLLANI)

Faqe 6 e 6

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
shpk